

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kurora ceremoniale, lule sezonale dhe peme dekorative”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03452000-3, 39296000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.487.720 lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Agjencia Parqeve Urbane ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetë deklaramit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kërkesave të kriterëve të shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlera e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3 ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qënë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën e procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit objekt prokurimi është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës ”Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për ”Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Është minimumi i kërkesës për arsye që të vërtetojë që ka kapacitet financiar për ta kryer këtë furnizim dhe shërbimet e lidhura me to. Rekomandimi nr. 1797/1 i datës 10.03.2022.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku
-

të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4, nenit 55 pika 4 germa b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe tek rekomandimi i nr. 1797/1 i datës 10.03.2022. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën e tre muajve të fundit Dhjetor 2025, Janar 2026, Shkurt 2026

Jo më pak se 1 (një) agronom të shoqëruar me diplomë, kontrate pune.

Jo më pak se 3 (tre) punonjës, të aftë për të kryer të gjitha shërbimet agro-teknike të bimëve dhe fidaneve që do të mirembahen në fidanishte deri në mbarimin e afatit të levrimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 40, pika, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient mbështetës të specializuar për të magazinuar bimët (fidanishte) me sipërfaqe jo më pak se 4.000 m² (kater mijë), me kushte optimale të furnizimit me ujë dhe plehërim. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton pronësinë/huapërdorjen/qeramarrjen:

a) Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qeramarrjen:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qera:

- Kontratë qeraje.

b) Foto të ambientit të magazinimit të bimët (fidanishte).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne piken 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 40, pika, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi teknik per piken 2.3.2, 2.3.3: Kriteret për kualifikim jane vendosur që t’i shërbejne autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Keto kriteret jane vleresuar si te nevojshme per arsye se duke qene se afati i levrimit do te jete per 8 muaj nga nenshkrimi i marreveshjes kuader, mbjellja e luleve dhe pemeve do te behet ne menyre periodike, te vazhdueshme pergjate vitit, duke e ndare ne dy faza dhe kjo kerkon domosdoshmerisht pjese te stafit nje agronom dhe punonjes te afte per te kryer te gjitha sherbimet agro-teknike te bimeve dhe fidaneve qe do te mirembahen ne fidanishte deri ne mbarimin e afatit te levrimit.

Lulet sezonale si: Begonia semperflorens vs9, Petunia vs9, Tagets vs9, Salvia splendens vs9, Kalanchoe vs14, Margarita vs14, Lantana vs14, Begonia semperflorens vs14, Dipladenia vs14 konsiderohen si lule sezonale qe kane si kohe te pershtatshme te celjes sezonin e veres dhe parashikohet mbjellja e tyre gjate periudhes Prill-Qershor sipas kushteve te mbjelljes.

Mbjellja e pemeve ka si kohe te favorshme sezonin e vjeshtes Shtator-Nentor sipas kushteve te mbjelljes, ku kryesisht kemi lulen Cyclamen vs14 (lule sezonale), Prunus Surelata (Qershia japoneze) vs 45 cm H 3.5-4 m, perimetri 18-20 cm, Acacia dealbata (Mimoza) vs 45 cm H 3.5-4 m perimetri 18-20 cm, Prunus Cerasifera (Kumbull e kuqe) vs 45 cm H 4-4.5 m perimetri 20-20 cm.

Gjithashtu kurorat ceremoniale te perbera nga (lule sezonale, dege dafine, pishe, si dhe shiritin me mbishkrimin per festa te caktuara) per cdo rast duhet te jene te fresketa dhe te pergatitura ne kohe reale.

Per sa me siper, Autoritetit Kontraktor i lind nevoja per vendosjen e ketyre kriterëve qe i arsyeton si te rendesishme per zbatimin me sukses te kontrates. Te pasurit nje fuqi punetore, agronom te specializuar dhe disponimin e nje ambienti (fidanishte) me kushte optimale te domosdoshme per mirembajtjen e objektit te kontrates deri ne finalizimin e saj, do te sillte gjithashtu edhe nje impakt cilesor ne fushen e gjelberimit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikaten e sistemit te menaxhimit te cilesise ISO 9001:2015 (e vlefshme dhe e akredituar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM Nr.285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve ISO, është menduar së ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në proporcion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë automjete për transportin e mallrave, të cilin duhet t’u ketë në pronësi/qera/marreveshje përdorimi si me poshte:

- Kamioncine, jo me pak se 1 (nje) në pronësi ose me qera.
- Kamion me vinc, jo me pak se 1 (nje) në pronësi ose me qera

Shenim : Per mjetet me status përdorimi qera/marreveshje përdorimi te disponohet kontrate qeraje mes qiradhenesit dhe qiramarresit shoqeruar me librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit.

Per mjetet me status pronesi te paraqese vertetim per pronesine shoqeruar me librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, mund të përcaktojë kritere të tjera, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter është i nevojshëm për të garantuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete profesionale për përbushjen e kontratës, duke u angazhuar jo vetëm për furnizimin e produkteve në përputhje me specifikimet teknike të dhëna, por edhe për ofrimin e shërbimit të transportit dhe shpërndarjes së tyre në afatet e kërkuara. Si rrjedhim Autoriteti Kontraktor krijon siguri për realizimin me sukses të kontratës në përputhje me specifikimet teknike sipas afateve e caktuara në Dokumentet Standarte të Tenderit.

Argumentimi teknik: Numri dhe lloji i mjeteve në pronësi/qera/marreveshje përdorimi është i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet në mënyrë periodike nga furnizuesi sipas nevojave të AK përgjatë vitit në ambientet ku do të mbillen keto bimë, si në rrethrotullimet e qytetit, në lulishte të ndryshme etj. Gjithashtu kamioni me vinc është i domosdoshëm për arsye se pemet janë me përmasa të mëdha që bëjnë të pamundur që të ngrihen me forca fizike nga punëtorët. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te dorezoje mostrat ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, per artikujt e meposhtem:

- 1.Begonia semperflorens vs9 (nana)
- 2.Petunia vs9
- 3.Margarita vs14
- 4.Begonia semperflorens vs14 (nana)
- 5.Lantana vs14
- 6.Dipladenia vs14

Mosparaqitja e mostrave perben shkak per skualifikim.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi., lidhur me të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësisia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit nga të gjithë anëtarët e njësisë që kanë akses (jane të autorizuar) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

NJËSIA E PROKURIMIT
